



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të nenit 66 të Ligjit nr. 08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenit 10 të Rregullores (KQZ) Nr. 02/2024 për pranimin e personelit të përkohshëm në KQZ, si dhe Vendimit nr.01/2189-2024 të KQZ, të datës 14.12.2024, për miratimin e grupit të pestë të pozitive për angazhimin e personelit të përkohshëm për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall:

## Konkurs

### Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Grupi i administrimit të përgjithshëm
Titulli i pozitës së punës	Monitorues i Fushatës së Zgjedhjeve
Arsyeja për rekrutim kontraktual	Për realizimin e një projekti
Koeficienti/Paga	5.25/ 577.50 Bruto
Nr. i kërkuar	45
Kohëzgjatja e emërimit	Me afat të caktuar
Data e njoftimit	30/12/2024
Afati për aplikim	30/12/2024 - 05/01/2025
Institucioni	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Departamenti	Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike
Divizioni	
Vendi i punës	Nga një (1) zyrtar në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Në komunat: Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Pejë, Mitrovicë e Jugut, Ferizaj dhe Gjakovë, nga dy (2) zyrtar.
Nr. i Referencës	RN00016237
Kodi	RPC0009776



## 1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

---

- Monitoron dhe mbanë evidencë për tubimet e subjekteve politike të certifikuara brenda komunës ku ushtron detyrën e monitoruesit sipas procedurave;
- Monitoron dhe mbanë evidencë për zyrat e subjekteve politike të certifikuara brenda komunës ku ushtron detyrën e monitoruesi;
- Monitoron dhe mban evidencë për vendosjen e billbordëve, posterave dhe materialeve tjera promovuese të subjekteve politike të certifikuara brenda komunës ku ushtron detyrën e monitoruesi;
- pas çdo procesi të monitorimit, monitoruesi raporton në njësinë për kontrollin financiar të subjekteve politike në Zyrën për Regjistrimin, Certifikimin dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike;
- monitoron vendosjen e materialeve të zgjedhjeve dhe njofton komisionin komunal të zgjedhjeve nëse vendosja e materialeve është në pajtim aktet ligjore, nënligjore dhe kodin e mirësjelljes;
- kujdeset për mirë menaxhim dhe ruan të dhënat konfidenciale;
- kryen detyra tjera sipas fushëveprimit, që caktohen nga udhëheqësi i Njesisë.

## 2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

---

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

## 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë/a universitare me së paku tri (3) vite të studimeve.
- **Lloji i arsimimit:** i pa specifikuar.
- **Përvoja:** Së paku një (1) vit përvojë pune.

## 4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

---

- Aftësi për realizimin e detyrave për të cilat nevojiten njohuri të dhela të një fushe të caktuar;
- përmbushja e detyrave në pozitat e kësaj klase realizohet duke ndjekur udhëzimet dhe praktikën institucionale;
- kërkohet që të zhvillohet një analizë e kujdesshme e informacionit faktik;
- mund të përshtatin procedurat, teknikat, mjetet materiale dhe/ ose pajisjet me nevojat e fushatës së veprimtarisë dhe mund të kryejnë punë të cilat nuk janë rutinë, por gjithmonë brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë;
- merr përgjegjësi specifike, pa mbikëqyrje, për interpretimin dhe zbatimin e një numri të procedurave dhe udhëzimeve administrative përmes vetë iniciativës, kur kërkohet një gjë e tillë.



## 5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

---

- Kopjen e letërnjoftimit/ pasaportës/ certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- Kopjen e diplomës së kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionit arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurën e nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjen e dëshmisë së punësimit (vërtetim/ kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë së punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personale;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucionin publik (vlen për të punësuar në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetë deklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve të aplikimit të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklarata në aplikacion.

### Dëshmitë që kërkohen në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/ e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më e vjetër se gjashtë (6) muaj nga data e lëshimit;
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore;
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.

## 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 20/01/2025, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 7. Kriteret specifike shtesë

---

## 8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervista – maksimumi 100 pikë

## 9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



## 10. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

### Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.
- **Patent shofer**

### Kërkesat shtesë sipas legjislacionit në fuqi:

- të mos ketë qenë anëtar i një subjekti politik tri (3) vite para paraqitjes së aplikimit për këtë pozitë;
- të mos ketë qenë donatorë i një subjekti politik tri (3) vite para paraqitjes së aplikimit për këtë pozitë;
- të mos ketë qenë në mënyrë të drejtpërdrejt ose të tërthortë në ndonjë marrëdhënie kontraktuale me një subjekt politik tri (3) vite para paraqitjes së aplikimit për këtë pozitë;
- të jetë banor i komunës përkatëse.

Komitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

